

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE, Departamenti i krimeve te renda, Kryetari i trupit gjykues Burim Ademi, me procesmbajtësen Xhemile Babatinci, ne lenden penale kundër te pandehurit [REDACTED] për shkak te veprës penale Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 422 lidhur me nenin 31 te KPK-se, sipas aktakuzës se Prokurorisë Themelore ne Mitrovice, PP.I.nr. 39/2014 dt.11.03.2015, ne mbështetje te nenit 358 par.1 e pika 1.3 lidhur me nenin 160 te KPP-ës , me date 13.09.2017, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. PUSHOHET PROCEDURA PENALE kundër te pandehurit [REDACTED] për shkak te veprës penale Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 422 lidhur me nenin 31 te KPK-se, pasi qe i pandehuri ka vdekur.
- II. Shpenzimet e procedurës penale mbesin barre e mjeteve buxhetore te kësaj gjykate.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore ne Mitrovice ka ngritur aktakuzën PP.I.nr. 39/2014 dt.11.03.2015 kundër te pandehureve: [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED] për shkak te vepres penale Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 422 lidhur me nenin 31 te KPK-se. Gjykata ndaj te pandehurve [REDACTED] dhe [REDACTED] ka vendosur me aktgjykimin P.nr.56/2015 te datës 19.12.2016 i cili aktgjykim nga gjykata e Apelit eshte ndyshuar, aktgjykim ky PAKR.nr.49/2017 te datës 17.03.2017. Ne raport me te pandehurin [REDACTED] kur gjykata kishte shqyrtuar aktakuzën ndaj te pandehurve tjerë per te pandehurin [REDACTED] eshte veçuar procedura penale, pasi qe i njejti kishte dorzuar dokumentacion mjekësor ne gjykate duke arsyetuar se i njejti vuante nga nje sëmundje e rende.

Gjykata është njoftuar nga prokuroria se i pandehuri [REDACTED] ka ndërruar jete, ashtu qe gjykata ka kërkuar nga Zyra për gjendje civile te komunës se Vushtrrisë te verifikohet fakti i vdekjes sipas certifikatës se Vdekjes, dhe zyra për regjistrimin e gjendjes civile ka njoftuar këtë gjykate se i pandehuri [REDACTED] ka vdekur dhe gjykatës ia ka dorëzuar Certifikatën e vdekjes te datës 12.09.2017 me te cilën konstatohet se i pandehuri është regjistruar ne regjistrin ame te të vdekurve në

numrin rendor 101 me numër protokollit [REDACTED], fakt ky i regjistrimit me date 12.09.2017.

Ne baze te dispozitave te nenit 358 par.1 nen par.1.3 lidhur me nenin 160 te KPP-ës gjykata e pushon procedurën penale nëse vërtetohet se i pandehuri ka vdekur,

për çka pasi qe ne rastin konkret një fakte i tille u vërtetua gjykata e pushoi procedurën e mëtutjeshme për te pandehurin [REDACTED] ne këtë çështje penale.

Për sa i përket shpenzimeve te procedurës penale gjykata ka vendosur për këto shpenzime ne baze te nenit 454 ka paraparë se kur pushohet procedura penale shpenzimet e procedurës paguhen nga mjetet buxhetore, për këtë arsye edhe ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktvendimi.

GJYKATA E THEMELORE NE MITROVICE

Departamenti për krime te renda

P.nr.103/17, date 13.09.2017.

Kryetari i Trupit Gjykses

Burim Ademi

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejt ankese në afat prej 3 ditësh, nga momenti i pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës se Apelit ne Prishtinë nëpërmjet kësaj gjykate.